

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: ***“Blerje ndriçues rruge”***

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **34993000-4**

VLERA E FONDIT LIMIT:

3,331,875 (tre milion e treqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh
3,998,250 (tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë me tvsh.

Vlera e fondit limit është përlllogaritur bazuar në Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”,i ndryshuar Kreu VI “rregulla të përgjithshme dhe përgatitja e procesit të prokurimit”,neni 34 “Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”,Vendimit nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar,neni 12 “Metoda të zbatueshme në përlllogaritjen e vlerës së kontratës”.Komisioni i perlllogaritjes se fondit limit i ngritur me Urdher Titullari nr.311 ,date 21.05.2026 pasi ka bere nje studim te tregut ka gjetur oferta nga operatore ekonomike qe operojne ne kete fushe dhe ka llogaritur mesataren e cmimit te tregut duke nxjerre dhe fondin limit per proceduren.***“Blerje ndriçues rruge”***

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Maliq ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet 2023-2024-2025 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, i ndryshuar, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 50 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, i ndryshuar, (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.2 Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2023,2024,2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

(Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 1 dhe pika 3 ,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar,ku percaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për ”Procedurës Tatimore ”neni 64 Deklarata Tatimore.

” Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.3Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, për vitin 2026 ,pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet sipas Ekstraktit te Rregjistrir Tregtar dhe per vitin 2026(**këstet e maturuara të vitit 2026**) sipas percaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimevetë nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzoje vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c,”, Pasi cdo operator ekonomik duhet te kete te paguara taksat dhe tarifate vendore prane njesive te qeverisjes vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga shpallja e njoftimit te kontrates ,ku vlera e kërkuar duhet të jetë jo me e vogel se 20% i fondit limit te kesaj kontrate

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin **publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuar sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore** ,ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin **privat**, operatori ekonomik duhet të paraqesë **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Ndriculesat të jenë të pajisur me certifikate të prodhimit Europian.

Argumentim: Në bazë nenit 77, pika 4 të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 3, pika 4, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që ndricuesat janë konform kërkesave dhe specifikimeve të kërkuara.

2.3.3 Në rastin kur operatori ekonomik është prodhues i mallrave të kërkuar, duhet të paraqesë fotot dhe kataloget e ndricuesave (*katalogu duhet të jetë i perkthyer në gjuhën shqip*). Në rastin kur nuk është prodhues i paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori së bashku me fotot dhe katalogun perkates të ndricuesave (*katalogu duhet të jetë i perkthyer në gjuhën shqip*).

Argumentim: Në bazë të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, germa b, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri operatori ekonomik i garanton Autoritetit Kontraktor se plotëson kapacitetet për furnizimin me materialet e kërkuara.

2.3.4 Operatorët ekonomik duhet të paraqesin nga një mostër për secilin mall të kërkuar nga autoriteti kontraktor. Mostrat do të paraqiten në ditën dhe orën e hapjes së ofertave të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Për paraqitjen e mostrave do të mbahet proces – verbal për të administruar procesin e dorëzimit midis Autoritetit Kontraktor dhe operatorit ekonomik.

Argumentim: Në bazë të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, germa a, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri Autoriteti Kontraktor do të verifikojë materialet nëse përputhen me specifikimet e kërkuara të mallrave si forma, ngjyra, standarti etj

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë në formularin përmbledhës të vetedeklarimit se do dorëzojë mallin në vendin e kërkuar sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, dhe sipas formularit të sasise dhe grafikut të shpërndarjes ,brenda 30 ditëve nga data e kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të të ligjit nr. 162/2020“Për prokurimin publik” dhe nenit 85, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,i ndryshuar, me anë të këtij kriteri Autoriteti Kontraktor siguron se do të furnizohet me mallrat e kërkuar brenda afatit të kontrates.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të deklarojë në formularin e vetedeklarimit se ka një punësim i të paktën 1 (një) punonjësi për muajin e fundit.

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti / enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

a. **Vërtetim** të lëshuar dhe konfirmuar (*me firme dhe vule*) nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit.

Dhe

b. **Listpagesate**konfirmuar (*me firmedhevule*) nga Administrata Tatimore të punonjësve sipas formatit që kërkohe nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

2.3.7 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në formularin e vetedeklarimit se ka të punësuar, minimalisht 1 punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- **(1) një punëtor të thjeshtë**

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti / enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. kontrata e punës e vlefshme

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohe që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Eshtë kërkuar 1(një) punonjës i nevojshëm për shkarkimin e materialeve në destinacionin e kërkuar